

Relacion per degjese me publikun “KELVIS -2013” Sh.p.k.

Mjedisi eshte burimi i gjithçkaje per te cilen njerezit kane nevojë per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomiko-social, prandaj duhet nje menaxhim sa me i mire i mjedisit.

Etapa e re e zhvillimit te hapësirave ne zonen e Komunes Nickel te Rrethit Kruje, ka sjelle qe te ndertohen dhe te kete komplekse te ndryshme te prodhimit industrial, ekspozimit te mallrave industriale, te sherbimit, te prodhimit dhe banimit ne kete zone.

Kjo edhe per vete faktin se zona ne komunën Nickel eshte nje zone mjaft e rendesishme per pozicionin gjeografik qe ka, per nga madhesia por edhe per vlerat dhe resortet qe mban si zone me aktivitet banimi, agro-kultural, bregdetar, turistik por dhe te zhvillimit industrise se mesme.

Hapësira ne zonen e Komunes Nickel te Rrethit Kruje kohet e fundit ka pesuar ndryshime te rendesishme ne aspektin ndertimor, arkitektonik dhe urbanistik.

Nje pejsazh i ri eshte formuar me ngritjen e shume objekteve me karakter industrial, ndertesa qe sherbejne per magazinim, ekspozim, perpunimin, ndertesa banimi dhe sherbimi, pika karburanti e mjaft objekte te ndryshme..

Zona ku eshte vendosur aktiviteti te cilit do ti behet monitorimi ze nje siperfaqe te mjaftueshme per zhvillimin e projektit.

Duhet theksuar se ne territorin perreth ka ndertime me karakter te njejte me ate te aktivitetit tone. Ky aktivitet perligj statusin e kesaj zone qe shtrihet ne Komunën Nickel te Rrethit Kruje si zone me destinacion urban, industrial dhe sherbimesh te ndryshme.

Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte dhe nje pjese e kesaj hapësire eshte siperfaqje e gjelber. Qarkullimi, hyrjet e daljet ne subjekt behen nga sheshi i ndertuar ne nje distance 80 m nga aksi kryesor Tirane-Fushe Kruje.

Kompania “Kelvis -2013” me seli ne Qereke, Nickel, Durres, ushtron aktivitetin ne Qereke, Nickel, Durres . Terreni eshte i fushor. Zona perreth dominohet nga toka te lena djerre e te pa shfrytezuara. Rruga kyesore lidhet me rruget hyrese dhe dalese te sistemuara dhe me hapësire per manovrimin e automjeteve. Infrastruktura egzistuese eshte e lidhur me infrastrukturen e zones.

Kompania do te pajiset me leje te tipit B pasi do te kryeje aktivitetet e ndryshme te klasifikuara ne tabelen e meposhteme sipas ligjit te lejeve.

		ID	Veprimtaria
1	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore
2	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme përprodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)
3	Blegtoria	7.8	d) Rritje intensive e gjedhit në një instalim e) rritje intensive të kafsheve të tjera

Aktivitetet subjekt të ligjit të lejeve janë:

Mbajtja e gjedhit dhe kafsheve në stalle për thertoren dhe shitje të tyre në tregun e kafsheve

Mbajtja e tyre realizohet në stalla me një teknologji bashkohore konform legjislacionit në fuqi dhe duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme. Falë impenjimit të vazhdueshëm të kompanisë dhe dedikimit të saj në blegtorinë bashkohore ky aktivitet është bërë i njohur lokalisht si lider në këtë sektor.

Stallat janë projektuar posaçërisht për këto funksione duke patur parasysh kërkesat dhe nevojat e posaçme që sjell ushtrimi i aktivitetit. Ato menaxhohen nga personeli i kualifikuar dhe që në fazat e projektimit të tyre janë marrë parasysh të gjitha aspektet logjistike e mjedisore të këtij lloji aktiviteti. Stallat janë projektuar për një kapacitet nën më shumë se 50 njësi gjedhi.

Thertore

Në shërbim të aktivitetit të kompanisë është edhe thertorja e këtij aktiviteti. Kjo thertore është projektuar dhe ndërtuar në baze të teknikave më të mira të disponueshme. Ajo është

pjesë e funksionimit të integruar të këtij aktiviteti. Thertorja mbahet në funksionim nga personeli i kualifikuar dhe i trajnuar për këto funksione. Kjo thertore është projektuar gjithashtu duke patur parasysh edhe praktikën me të mira mjedisore.

Magazini frigoriferik

Në funksion të aktivitetit të integruar të këtij kompleksi janë edhe dhomat frigoriferike. Ato janë të lidhura ngushtë me aktivitetin e thertores. Ato janë dhoma frigoriferike me shkallë të ulët ftohjeje. Për llojin e aktivitetit nevojitet edhe ngrirje e thellë. Dhomat frigoriferike janë projektuar dhe ndertuar në funksion të këtij kompleksi. Mirembajtja e tyre bëhet vetëm nga personeli i kualifikuar.

Prodhimi i ushqimit për kafshë

Në brendësi të kompleksit ndodhet edhe ambienti për përgatitjen e ushqimit të kafshëve. Kafshët sipas moshave të ndryshme kanë nevojë për ushqime specifike me raporte të ndryshme perberësish. Përzjerja e këtyre ushqimeve realizohet në kapanonin e prodhimit të ushqimit të kafshëve sipas nevojave të kompleksit. Në këtë departament realizohet vetëm përzjerja e ushqimeve dhe jo prodhimi i tyre.

Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët

Kjo fazë e aktivitetit është akoma në projektim. Është projektuar funksionimi i departamentit për prodhimin e sallameve dhe produkteve të tjera ushqimore me baze mishi. Funksionimi i këtij departamenti do të jetë pjesë e ciklit të mbyllur të funksionimit të kompleksit blegtoral. Edhe ky aktivitet do të bazohet në teknikat me të mira të disponueshme dhe në teknologjinë bashkohore.